

VENDIM
Nr. 815, datë 26.11.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 175, DATË 6.3.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LUSHNJË, TË QARKUT TË FIERIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “k”, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën përfundimtare të pronave që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnjë, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr. 175, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi i destinacionit të sipërfaqes 1 300 (një mijë e treqind) m², truall, pjesë e pronës me numër rendor 175 e me numër pasurie 13/4, sipas planimetrisë bashkëlidhur, nga fusha e përdorimit “Zhvillim ekonomik” për t’u përdorur për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë e Lushnjës.


2. Bashkisë së Lushnjës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia e Lushnjës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT
EMRI I OBJEKTIT : GODINE BANIMI & SHERBIMI 8 KAT, TIP 83/5
LAGJA "GAFURR MUÇO", LUSHNJE SHKALLA 1:500



POZICIONI KADASTRAL 8571
NUMRI I PASURISE 13/4



PLANVENDOSIA NE BAZON
L "GAFURR MUÇO" LUSHNJE SH 1:2500



MIRATOHET
KRYETARI I K.R.R.T TE BASHKISE LUSHNJE
FATOS TUSHE

DREJTOR I URBANISTIKES TE BASHKISE
MIMOZA HAXHIU

INVESTITORI
ENTI KOMBETAR I BANESAVE

KONDIKIONE URBANE :

Sipërfaqja e TRUALLIT	2986 m ²
Sipërfaqja e Ndërmarrjes së Pasurisë Publike	719 m ²
Sipërfaqja e Ndërmarrjes N. të Pasurisë Publike	456 m ²
Sipërfaqja e Ndërmarrjes të Territorit	877.5 m ²
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	44.6%
Lartësia max.e objektit	24 m
Volumi i objektit	21600 m ³
Distanca nga aksi i rruges mesatarisht	32 m

BANIMET LUSHNJE		INV. ENTI KOMBETAR I BANESAVE	
OBJEKTI :		A-01	
GODINA BANIMI 8 KAT L "Gafurr Muço" Lushnje		2011	
SHEKILLI I PLANIT :			
PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT			